



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2018:052245

Datë: 07.05.2019

Numri i dokumentit: 00302402

P.nr.188/18

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore Prizren – dega në Suharekë, Gjyqtari Robert Tunaj, me sek. juridike F. Kabashi, duke vendosur në lëndën penale kundër të akuzuarit F. H. B. nga fshati S., për shkak të veprës penale vjedhje e rendë nga neni 253 par. 1 të KPK, duke vendosur sipas aktakuzës së PTH në Prizren PP.nr.2251/12 të dt.29.03.2017, në seancën gjyqësore të mbajtur me dt.06.05.2019, në prezencë të PSH në Prizren Shpend Binaj, të akuzuarit, muarrë dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari F. B. nga i ati H., e ëma M., e lindur B., i lindur me dt.30.08.1979, nga fshati S., ka të kryer shkollën fillor, i martuar baba i tre fëmijve, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Se me dt. 29.03.2012 në mesnatë, në Suharekë në lagjen “F.” me qellim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo personin tjetër, merr pasurin e luajtshme të dëmtuarit A. Sh., në atë menyrë që me përdorimin e forcës e then xhamin e derës së pasme të anës së majtë të automjetit të markës “VW G. 4”, me targa 04 ... AG, me pas e hap derën e automjetit dhe nga aty merre një CD-player dhe DVD në vlerë prej 200,00 euro, një çantë dore, një stetoskop në vlerë prej 150,00 euro dhe medikamente të ndryshme në vlere prej 35.00 euro dhe ik nga vendi i ngjarjes.

Këso dore ka kryer veper penale vjedhje e rendë nga neni 253 par. 1 të KPPK.

Andaj gjykata në mbështetje të neneve 3,34,36,38,64,66,67,73 dhe nenit 253 paragrafi 1 të KPPK. të akuzuarin, e

G J Y K O N

Të akuzuarin **F. B.** e gjykon me denim me burg efektiv prej **3 muaj** i cili do të bëhet i ekzekutueshëm pas plotëfuqishmeris së këtij aktgjykimi.

I akuzuari lirohet nga shpenzimet e procedurës pasi që është i kategoris sociale dhe për një periudhë të gjatë është në vuajtje të dënimit.

I dëmtuari A. N. Sh. nga Suhareka, për realizimin e kërkeses pasuroro- juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Arsyetim

PTH në Prizren me aktakuzën PP.nr.2251/12 të dt. 29.03.2017, ka akuzuar F. H. B. nga fshati S., aktakuzën të cilën gjatë seances gjyqësore prej fillimit gjerë në mbarimin e saj e ka perfaqësuar PSH Shpend Binaj, i cili ka bere rikualifikimin e veprës penale vjedhje e rende nga neni 327 par. 1 nen paragrafin 1.1 te KP 04/L-082 ne veprën penale vjedhje e rende nga neni 253 par. 1 të KPPK, pasi qe vepra është kryer me dt. 29.03.2012 në ate kohë ka qene ne fuqi Kodi i Përkoshem Penal i Kosovës i cili edhe është ligj me i favorshëm per te pandehurit , me kërkesen që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të denohet sipas ligjit.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt.06.05.2019 dhe në vetë pranimin nga ana e të akuzuarit ka vërtetuar këte gjendje faktike:

Në tërësi është vërtetuar se me datën 29.03.2012 në mesnatë, në Suharekë në lagjen “F.” me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm per vete apo personin tjetër, merr pasurin e luajtshme të dëmtuarit A. Sh., në atë menyre që me përdorimin e forcës e then xhamin e derës së pasme të anës së majtë të automjetit të markës “VW G. 4”, me targa 04 ... AG, me pas e hap derën e automjetit dhe nga aty merre një CD-player dhe DVD në vlerë prej 200,00 euro, një çantë dore, një stetoskop në vlerë prej 150,00 euro dhe medikamente të ndryshme në vlere prej 35.00 euro dhe ik nga vendi i ngjarjes.

Ketë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga vetë pranimi i të akuzuarit i cili në shqyrtim gjyqësor vullnetarisht e ka pranuar fajsin .

Gjykata sipas detyrës zyrtare në shkresat e lëndës nuk ka gjetur ndonjë provë të pa pranueshme dhe poashtu gjykata ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajsis, pranimi i fajit nga ana e të akuzuarit është bërë vullnetarisht në shqyrtimin gjyqësor, pranimi është mbështetur në faktet e qështjës që përmban aktakuza, siq janë raporti i oficerit nr 2012-Gb-2.. të dt. 29.03.2012, listën e dëshmimeve, raporti i këqyrjes nga vendi i ngjarjes dhe fotodokumentacioni, si prova materiale të paraqitura ndaj të akuzuarit nga ana e PTH në Prizren.

Gjykata poashtu në tërësi ka ardhur në përfundim se pranimi i fajsis ne shqyrtimin gjyqësor nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 248, nga se nuk egziston ndonjë nga arsyerat dhe kushtet për hudhjen e aktakuzes, apo pushimin e procedurës penale si dhe nenit 253 te KPP. Dhe nga këto fakte të cilat i përmban aktakuza, gjykata ka ardhur në përfundim se me veprimin e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qënjës së veprës penale vjedhje e rende nga neni 253 par. 1 te KPPK, gjykata ka vendosur të akuzuarin ta shpallë fajtor, dhe tia shqipton denimin me burg efektiv në kohëzgjatje prej 3 muaj,i cili do të bëhet i ekzekutushëm pas plotefuqishmeris se këtij aktgjykimi..

Gjykata gjatë marrjes së vendimit mbi denimin ka vlersuar të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 64 të KPPK.

Gjykata si rrethanë letësuese pati parasyshë se i akuzuari ka patur qëndrimin korrekt ndaj gjykatës, është penduar për veprën e kryer, është familjar, nga kryerja e veprës deri me

sod ka kaluar një kohë e gjatë, kurse si rrethan rënduese faktin se edhe më parë është denuar për veper penale të natyres së njëjt.

Gjykata ka shqiptuar denim nën minimumin e parapar ligjor në përputhje me nenin 66 dhe 67 të KPPK-së tëpasi që ka vlersuar si rrethana posaqerisht letësuese faktin që i akuzuari vullnetarisht ka pranuar fajsin dhe periudhen e gjate kohore që ka kaluar nga koha e kryerjes se vepres e deri ne gjykim e bindur se edhe me këtë denim do të arrihet qëllimi i denimit në parandalimin e kryersit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen dhe rehabilitimin e tij dhe poashtu me këtë denim do të arrihet të ndikohet në ngritjen e vetëdijes shoqërore dhe moralit për respektim të ligjit dhe parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimi mbi kërkesen pasuroro juridike u muarrë në kuptim të nenit 463 te KPP.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u muarrë në kuptim të nenit 453 paragrafi 4 të KPP.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NE SUHAREKE,
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHEM
P.nr.188/18 të dt. 06.05.2019**

Sek. Juridike
F. Kabashi

G j y q t a r i
Robert Tunaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.